

Policia në kërkim të dy personave në Prizren, dyshohen për vjedhje të rëndë



01/02/2023 16:45



Sektori i Rajonal i Hetimeve i drejtorisë Rajonale të Policisë në Prizren është duke zhvilluar hetime lidhur me veprën penale vjedhje e rëndë, që ka ndodhur me datë 03.03.2022 , rreth orës 20:30 në një shtëpi në, në rrugën “Hazir Tolaj”.

“Më 03 mars 2022 është raportuar një rast vjedhje e rëndë që ka ndodhur në një shtëpi në rrugën “Hazir Tolaj” në Prizren, ku dyshohet se persona të dyshimte kane shfrytëzuar mos prezencën e familjareve në shtëpi dhe kane arritur të vjedhin kasafortën, në kasafortë ka pasur stoli ari me vlerë prej 20 mijë eurosh si dhe një arme zjarri-pistoletë, thuhet mes tjerash në njoftimin e policisë.

Njoftimi i plotë:

Sektori i Rajonal i Hetimeve i drejtorisë Rajonale të Policisë në Prizren është duke zhvilluar hetime lidhur me veprën penale “Vjedhje e rëndë”, që ka ndodhur me datë 03.03.2022 , rreth orës 20:30 në një shtëpi në, në rrugën “Hazir Tolaj” në Prizren.

Me date 03/03/2022 rreth orës 20:30 . është raportuar një rast “Vjedhje e Rende” që ka ndodhur në një shtëpi në Rr.Hazir Tolaj ne Prizren, ku dyshohet se persona të dyshimte kane shfrytëzuar mos prezencën e familjareve në shtëpi dhe kane arrit te vjedhin kasafortën, në kasafortë ka pas stoli ari me vlerë prej njëzet mijë euro (20.000) , si dhe një arme zjarri-Pistoletë model Tanfoglio Compact F ,9x9mm në emër te Viktimës.

Të dyshuarit kërkohen për veprën penale “Vjedhje e rëndë ”.

Sektori Rajonal i hetimeve në Prizren ka bërë përpjekje maksimale në ndriçim të veprës penale dhe ka siguruar 2 fotografi nga kamerat e sigurisë, mirëpo deri tani nuk ka rezultuar në identifikim e të dyshuarve.

Andaj Policia e Kosovës – Sektori Rajonal I Hetimeve në Prizren, bazuar në ligji për publikimin e fotove me shënime tjera të personave të kërkuar, me Autorizim të Prokurorisë Themelore në Prizren, me qëllim identifikimit, lokalizimin dhe rrjedhimisht arrestimin e dyshuarave, Kërkon që :

Kushdo që ka informacion për identitetin apo vendndodhjen e personave të dyshuar në fotot e bashkangjitur, të lajmërojë Policinë e Kosovës apo të lajmërohet në stacionin më të afërt policor.

Numrat e telefonit dhe adresat elektronike kontaktuese për të kontaktuar Policinë e Kosovës:

– 192 dhe 080019999 (pa pagesë)

– E-mail adresa: info@kosovopolic.com.



Artikuj të ngjashëm



February 2, 2023

Bajrami: Koeficienti të jetë 125, sepse me koeficientin e vendosur nga...



February 2, 2023

Hiqet nga rendi i ditës pika për shkarkimin e Bordit të KPMM-së



February 2, 2023

Shtohen rastet e testimave për Covid19, bëhet thirrje për imunizim



February 2, 2023

Presidentja Osmani udhëton për në Islandë



February 2, 2023

Arrestohet një person në Prizren, dyshohet për ngacmim seksual



February 2, 2023

Emërimi i njeriut të VV-së si drejtor në RTK, ambasada britanike:...

Other Links

